




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.448 /19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Goran Milenković- Kryetar, z. Nuhi Paçarizi- Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OENSHT “ViktoryCom&CompanyMurseli” shpk-Gjakovë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE: “ARFA GRUOP SH.P.K-Deçan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugës Radoniqit –Kontratë tri vjeçare”, me nr. të prokurimit 19-2012-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues/AK/ -Komuna e Gjakovës, më datën: 15.08.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: NSHT “Viktory Com & Company Murseli” sh.p.k- Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugës Radoniqit – Kontratë tri vjeçare”, me nr. të prokurimit 19-2012-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ -Komuna e Gjakovës.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës me titull: “Ndërtimi i rrugës Radoniqit –Kontratë tri vjeçare”, me nr. të prokurimit 19-2012-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues/AK/ -Komuna e Gjakovës dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V.Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues NSHT “ViktorCom&CompanyMurseli “sh.p.k-Gjakovë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI.Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Data e njoftimit për kontratë është bërë:08.04.2019.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është bërë:06.06.2019.

Data e hapjes së ofertave është bërë: 06.06.2019.

Data e përfundimit të rivlerësimit të ofertave është bërë: 09.07.2019.

Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues të eliminuar është bërë:11.07.2019.

Data e vendimit të AK për dhënien e kontratës është bërë: 11.07.2019.

Data e kërkesës për rishqyrtim është bërë: 16.07.2019.

Data e vendimit të AK –së, lidhur me kërkesën për rishqyrtim është bërë: 19.07.2019.

Operatori ekonomik ankues NSHT “ViktorCom&CompanyMurseli “ sh.p.k- Gjakovë,si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 26.07.2019 me nr. 448/ 19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugës Radoniqit –Kontratë tri vjeçare”, me nr. të prokurimit 19-2012-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues/AK/-Komuna e Gjakovës,duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1,6,7,56,59,60,69 dhe 72,të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit,konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së,me datë: 30.07.2019, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit raporton e dt:07.08.2019,lidhur me pretendimin ankimore të OE-

ankues konstaton si vijon.

Përgjigjjanëpretendimin 1.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 6, 7, 56, 59, 60 dhe 72 të LPP-së, me arsyetimin se: Autoriteti Kontraktues na ka eliminuar pa të drejt dhe nuk na ka kërkuar dokumente shtesë mbi këtë aktivitet të prokurimit i cili ka mundur që të kërkojë dokumente shtesë dhe të plotësojë nenin 72, Pra autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës ka bërë shkelje të LPP te Nenit 72 dhe Nenit 56. Faktet dhe argumentet mbi dosjen e tenderit të dorëzuar nga kompania jone:

Oferta e Grupit tone ka qene oferta me çmimin me të ulët në këtë aktivitet të prokurimit ku i kemi plotësuar të gjitha kriteret për kontratë, po sipas nenit 1 Qëllimi në duhet të jemi fitues i këtij aktiviteti të prokurimit.

Pika 1

Iso Standard i Paraqitur nga Ne si lider është Original dhe nuk duhet të noterizohet.

OE Murseli është i licencuar për të gjitha këto iso standarde pra iso Standardi i Kërkuar nga ju Pass 99-2012 mund të merret nga OE vetëm atëherë kur është i pajisur për Iso 9001-2015, 39001-2012, 14001-2015 pra OE Murseli e ka edhe të Noterizuar dhe mund të ju argumentojmë me Fakte për AK komuna e Gjakovës ka bërë shkelje të LPP përkatësisht nenin 72 dhe si pas RROUPP-ës 'Mungon certifikata ISO mund të kërkojnë informata sqaruese 69'

Pika 2.

Kapaciteti teknik dhe profesional: Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratë të natyrës së ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë.

Në një vlerë prej jo më pak se 750.000,00€, në rast konzorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% kontratë të natyrës së ngjashme,

Vlera që duhet të plotësojë lideri është e llogaritur kështu: $750,000.00 - 40\% = 450,000.00$ mijë

Referencat e kompanisë tone janë shumë me shumë se siç ka kërkuar AK Komuna e Gjakovës.

Siç janë:

Ndërtimi i rrugës Fehmi Agani me vlerë prej 198,119.80 + 10%

Ndërtimi i rrugës në Fshatin Zhub me vlerë prej 149,348.80 + 10%

Ndërtimi i rrugës Nimon Ferizi me Vlerë prej 38,728.85

Furnizimi i rrugëve me zhavorr me Komunën e Klinës në vlerë prej 43.000.00

Sanimi i rrugëve me zhavorr Komuna e Gjakovës në vlerë prej 410,000.00

Ndërtimi i rrugës së Kishës në Fshatin Bec në vlerë prej 15,000.00

Ndërtimi i shtigjeve për ecje në parkun e qytetit në vlerë prej 69,000.00 + 10%

Pejsazhi i mbrojtur Shkugeza-Ndërtimi i shtigjeve për ecje në vlere prej 98,520.00

Ndërtimi i oborrit dhe ndërtimit në vlere prej 55,000.00

Mirëmbajtja e gjelbërimit të qytetit dhe mbledhja e drunjëve dekorative në vlere prej 87,000.00

Ndërtimi i rrugëve se bashku me Benitacompany ne vlere prej 25,000.00

Vlera totale e kontratave është:778,717.45 dhe i posedojmë të gjitha me kontrata dhe mund të ju argumentojmë me fakte”,

duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit të lëndës eksperti shqyrtues konstaton se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë pjesërisht të bazuara sepse AK respektivisht komisioni i vlerësimit me rastin e vlerësimit të ofertave dhe eliminimit të OE ankuese me arsyetimin se: “Ju si operator ekonomik ju mungon Licenca 9001-20015 nuk është e noterizuar dhe Lista e kontratave nuk e plotëson 60% e shumës së kërkuar si bartës i konzorciumit” nuk ka vepruar konform kërkesave dhe dëshmime të parashtruara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit si vijon: ”

kërkesat:

1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë. Në një vlerë prej jo më pak se 750.000,00€, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% kontrata të natyrës së ngjashme.

5. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licenca ISO - ISO 9001 2015- Certifikimi I sistemit për Menaxhimin e Cilësisë - ISO 39001 2012- Sistemi I Menaxhimit të Sigurisë së Trafikut Rrugor - PASS 99 2012- Sistemi I Integruar I Menaxhimit - ISO 14001 2015- Sistemi

dëshmitë:

1. Një listë të kontratave të realizuara, duke saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve.

5. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licenca ISO valide-kopje të noterizuara.”

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankuese se bashku me dosjen e tenderit ka dorëzuar listat e kontratave të realizuara nga dy anëtarët e konzorciumit, ku në listën e kontratave të dorëzuara nga OE “VictoryCom” si lider i konzorciumit janë paraqitur të dhënat për kontrata të natyrës së ngjashme si vijon:

1 .Sanimi i rrugëve me zhavorr Komuna e Gjakovës në vlere prej 410,000.00-e filluar2013 dhe përfunduar 2015,

2.Furnizimi dhe mirëmbajtja e rrugëve me zhavorr nërrugëtlokale dhe Gjurgjevik të madh ne vlerë prej 43.700.00-e filluar 2018 dhe përfunduar 2018,

- 3 .Ndërtimi i shtigjeve përkëmbësor Parku i Qytetit ne vlere prej 69,000.00 - e filluar 2015 dhe përfunduar 2016,
- 4 .Ndërtimi i rrugësFehmiAgani me vlere prej 198,119.80- e filluar 2015 dhe përfunduar 2017,
- 5 .Ndërtimi i rrugës ne Fshatin zhub me vlere prej 149,348.80- e filluar 2015 dhe përfunduar 2017,
- 6 .Mirëmbajta e parqeve dhe mbjellja e drunjvedekorative ne vlere prej 88,000.00- e filluar 2015 dhe përfunduar 2017,
- 7 .Ndërtimi dhe Asfaltimi i rrugës NimonFerizi me Vlere prej 38,600.00e filluar 2018, dhe përfunduar 2018,
- 8 .Ndërtimi dhe sanimi i oborrit në vlere prej 15,000.00e filluar 2017 dhe përfunduar 2018,
- 9 .Pejsazhi i mbrojtur Shkugeza-dhe asfaltimi i shtigjeve në vlere prej 98,000.00e filluar 2018 dhe përfunduar 2018.

Nëse mblidhen vlerat e kontratave që janë përshkruar më lartë e që kanë përfunduar gjatë tri viteve të fundit (2016,2017 dhe 2018) mund të konstatojmë se vlera e tyre e përbashkët është e barabartë me 699,767.00 €, e cila vlerë është më e madhe se sa 60% i vlerës 750.000,00€ të kërkuar nga AK. Po ashtu OE ankuese ka bashkangjitur edhe referencat për kontratat në fjalë.

Ndërsa sa i përket certifikatës ISO 9001:2015, eksperti shqyrtues konstaton se OE ankuese e ka të bashkangjitur ne e-prokurim certifikatën në fjalë por nuk e ka të bashkangjitur dëshminë se e njëjta është e noterizuar siç është kërkuar nga AK.

Duke pasur parasysh faktet e cekura me larte si dhe ofertën financiare të OE ankuese e cila është më e lirë në vlerë prej 5.340.00 € se sa oferta e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, eksperti shqyrtues mendon se AK me rastin e vlerësimit të ofertave është dashur që ta kenë parasysh nenin 1 dhe 6 të LPP-së respektivisht qëllimin e ligjit të prokurimit publik që fondet dhe burimet publike të përdoren në mënyrë sa më ekonomike dhe efikase dhe në zbatim të kësaj është dashur që në përputhje me paragrafin 4 te nenit 59 dhe nenin 72 të LPP-së, të kërkojnë sqarime shtesë lidhur me vlerën e kontratave dhe certifikatën e ISO 9001:2015, me qëllim që ti eliminojnë dyshimet, para se të marrin vendim që ta eliminojnë OE ankues nga kjo procedurë e prokurimit.

Përgjigjja në pretendimin 2

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 69 të LPP-së, duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit te lendes, eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i operatorit ekonomik ankues nuk është i bazuara sepse OE ankuese pretendimin ne fjale vetëm e ka cekur sipërfaqësisht pa sqaruar dhe pa dhënë ndonjë fakt rreth shkeljes se këtij neni në deklaratën e ankesës se dorëzuar, po ashtu me nenin 69 të LPP-së rregullohen respektivisht udhëzohen autoritetet kontraktuese se si mund të

kërkojnë dhe vendosin në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë kërkesat minimale dhe cilat dëshmi duhet të dorëzohen nga OE lidhur me aftësitë teknike dhe/ose profesionale, gjatë ushtrimit/zhvillimit të një aktiviteti të prokurimit, andaj pretendimi rreth shkeljes së nenit në fjalë nuk qëndron.

Përgjigja në pretendimin 3

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 6, 7, 56, 59, dhe 60 të LPP-së, me arsyetimin se: "OE i cilësuar nga AK Komuna e Gjakovës si i suksesshëm nuk i plotëson as kriteret minimale për kontratë siç janë:

Pika 1.

1 .Inxhinieri i cili selite prezantuar nga OE nuk i plotëson kushtet pasi që ai nuk është INXHINER I KOMUNIKACIONIT POR MAGJISTER I SHKENCAVE TEKNIKE pra po i njëjti është edhe profesor në fakultetin e Makinerisë. Për të plotësuar kriterin e dosjes së tenderit po i njëjti duhet të ishte me titull: INXHINER I MAKINERIS DREJTIMI KOMUNIKACIONE ose MASTER!MAKINERIS DREJTIMI KOMUNIKACION. Sipas RROUPP-ës kur inxhinier nuk i plotëson kushtet duhet refuzuar.

Pika 2,

2. Inxhinieri i cili është prezantuar nga OE nuk i plotëson kriteret sipas Dosjes së tenderit. Personeli i cili është prezantuar nga OE ka titullin: Inxhinieri i Ndërtimit Civil-Industrial, pra për ta plotësuar Kriterin e dosjes së tenderit duhet të ishte Inxhinieri i Ndërtimitars-Drejtimi Konstruktiv.

Inxhinier Industrial do të nënkupton inxhinier i Fabrikave industriale pra që ka lidhje me ndërtimin e fabrikave dhe pjesëve të saj e që është drejtim krejt tjetër me Konstruktivin siç e kërkon dosja e tenderit Pra ky inxhinier nuk i plotëson kushtin si inxhinier të ndërtimitarsë- drejtimin konstruktiv.

Pika 3.

3 .OE ka paraqitur një inxhinier të hidros por Kontrata nuk është e nënshkruar nga të dy palët dhe është në kundërshtim me LPP dhe duhet cilësuar si dokument i pa vlefshëm nga AK.

Pika 4.

4 .OE ka paraqitur një marrëveshje me një OE tjetër për Shkëmb të Fort kurse Licenca është për sortus, pra i cili nuk i plotëson kriteret në dosjen e tenderit, Sortuesi është (separacion i cili bën lartësi e zhanoreve të lumit)

I mungon Baza e shkëmbit të fort (Gurëthyesit). Dhe duhet eliminuar gjithësi në bazë të RRUOPP-së.

Pika 5.

Nuk është Plotësuar Aneksi 6 lista e projekteve siç është në dosjen e tenderit por as Aneksi 7 Lista e makinerisë siç është në dosjen e tenderit, ka makineri me qera por nuk janë askund në listë të makinerisë siç do të duhet të plotësohet siç e thotë Lista e Makinerisë.

Pika 6

6, Lista e Çmimeve nuk është plotësuar sipas RROUPP-ës, pasi dhe OE nuk e ka nënshkruar Listën e çmimeve por vetëm ka vulosur dhe sipas RROUPP-ës ky duhet refuzuar menjëherë pa kërkuar sqarime shtesë.

Pika 7.

OE nuk i ka dëshmuar Punëtorët as me kontrata por as listën e ATK-se por vetëm një listë e cila nuk është e vlefshme nëqoftë se nuk paraqitet lista e ATK-se ose kontratat e punës”, duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit të lëndës eksperti shqyrtues konstaton se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë pjesërisht të bazuar sepse sa i përket pretendimeve lidhur me dokumentacionin e inxhinierit të komunikacionit, inxhinierin e ndërtimtarisë, kontratës me inxhinierin e hidros, listës së çmimeve, listës së punëtorëve, operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar dëshmitë që plotësojnë kërkesat e AK respektivisht ka dorëzuar kopjen e diplomës dhe vendimeve mbi njohjen e titullit për inxhinierin e ndërtimtarisë, kopjen e diplomës së magjistratit të shkencave teknike (sipas informacioneve të marruara dhe barasvlershme me inxhinierin e komunikacionit), kontratën mbi veprën me inxhinierin e hidros e cila është e nënshkruar nga dy palët, lista e punëtorëve konform kërkesë së AK sepse nuk është kërkuar të dorëzohet listë nga ATK, si dhe ofertën financiare e cila është e vulosur dhe e nënshkruar, ndërsa qëndron fakti se OE e rekomanduar për kontratë nuk e ka dorëzuar Aneksin 6 listën e projekteve siç është kërkuar me dosjen e tenderit por një listë të hartuar nga ana e vetë si dhe ka dorëzuar marrëveshjen me një OE tjetër për furnizim me zhavor-gurë të thyer shkëmbor ndërsa ka dorëzuar licencë sortuesi, ndërsa kërkesa ka qenë që të dorëzohet si dëshmi - licencë për bazë për gurthyes.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa nr.448/19, të datës: 26.07.2019, e OE-së: NSHT “ViktorCom&Company Murseli” shpk-Gjakovë, të aprovet si pjesërisht e bazuar (për arsyeje që u cekën tek përgjigjet në pretendimet 1,2 dhe 3 të ankesës), të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës i AK-së, dhe rekomandon që lënda të kthehet në Rivlerësim.

Operatori ekonomik NSHT “ViktorCom&Company Murseli” shpk-Gjakovë, përmes parashtrësme shkrim të datës: 13.08.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 15.08.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues, eksperti profesional i prokurimit, ndërsa përfaqësuesi i AK-së, nuk ka qenë në seancë edhe pse i njëjti është ftuar në mënyrë të rregullt, ku u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtrësat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së ankues z. Qerimi deklaroj: Ne pajtohemi me plotësisht me mendimin e Eksperti Shqyrtues.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti profesional i prokurimit z. Krasniqi deklaroj: Qëndroj prapa raportit të ekspertizës.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së z. Qerimi deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues të aprovoj ankesën tonë si të bazuar dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 6, 7, 56, 59, 60 dhe 72 të LPP-së, me arsyetimin se: Autoriteti Kontraktues na ka eliminuar pa të drejt dhe nuk na ka kërkuar dokumente shtesë mbi këtë aktivitet të prokurimit i cili ka mundur që të kërkojë dokumente shtesë dhe të plotësojë nenin 72. Pra autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës ka bërë shkelje të LPP të Nenit 72 dhe Nenit 56. Faktet dhe argumentet mbi dosjen e tenderit të dorëzuar nga kompania jone:

Oferta e Grupit tone ka qenë oferta me çmimin me të ulët në këtë aktivitet të prokurimit ku i kemi plotësuar të gjitha kriteret për kontratë, po sipas nenit 1 Qëllimi në duhet të jemi fitues i këtij aktiviteti të prokurimit.

Pika 1

Iso Standard i Paraqitur nga Ne si lider është Origjinal dhe nuk duhet të noterizuar.

OE Murseli është i licencuar për të gjitha këto iso standarde pra iso Standardi i Kërkuar nga ju Pass 99-2012 mund të merret nga OE vetëm atëherë kur është i pajisur për Iso 9001-2015, 39001-2012, 14001-

2015 pra OE Murseli e ka edhe te Noterizuar dhe mund të ju argumentojmë me Fakte për AK komuna e Gjakovës ka bere shkelje te LPP përkatësisht nenin 72 dhe si pas RROUPP-ës
'Mungon certifikata ISO mund të kërkohen informata sqaruese 69'

Pika 2.

Kapaciteti teknik dhe profesional: Operatori ekonomik duhet të ofroje dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës se ngjashme ne 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë.

Në një vlerë prej jo më pak se 750.000,00€, në rast konzorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% kontrata të natyrës se ngjashme,

Vlera që duhet të plotësoj lideri është e llogariten kështu: $750,000.00 - 40\% = 450,000.00$ mijë

Referencat e kompanisë tone janë shumë me shumë se siç ka kërkuar AK Komuna e Gjakovës.

Siç janë:

Ndërtimi i rrugës Fehmi Agani me vlere prej 198,119.80+ 10%

Ndërtimi i rrugës në Fshatin zhub me vlere prej 149,348.80+10%

Ndërtimi i rrugës Nimon Ferizi me Vlere prej 38,728.85

Furnizimi i rrugëve me zhavorr me Komunën e Klinë ne vlerë prej 43.000.00

Sanimi i rrugëve me zhavorr Komuna e Gjakovës në vlere prej 410,000.00

Ndërtimi i rrugës se Kishës në Fshatin Bec ne vlere prej 15,000.00

Ndërtimi i shtigjeve për ecje në parkun e qytetit në vlere prej 69,000.00+10%

Pejsazhi i mbrojtur Shkugeza-Ndërtimi i shtigjeve për ecje në vlere prej 98,520.00

Ndërtimi i oborrit dhe ndërtimit në vlere prej 55,000.00

Mirëmbajta e gjelbërimit të qytetit dhe mbledhja e drunjëve dekorative në vlere prej 87,000.00

Ndërtimi i rrugëve se bashku me Benita company ne vlere prej 25,000.00

Vlera totale e kontratave është: 778,717.45 dhe i posedojmë të gjitha me kontrata dhe mund të ju argumentojmë me fakte”.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues se AK respektivisht komisioni i vlerësimit me rastin e vlerësimit të ofertave dhe eliminimit të OE ankuese me arsyetimin se: “Ju si operator ekonomik ju mungon Licenca 9001-20015 nuk është e noterizuar dhe Lista e kontratave nuk e plotëson 60% e shumës së kërkuar si bartës i konzorciumit” nuk ka vepruar konform kërkesave dhe dëshmime të parashtruara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit si vijon: “

kërkesat:

1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë. Në një vlerë prej jo më pak se 750.000,00€, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% kontrata të natyrës së ngjashme.

5. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licenca ISO - ISO 9001 2015- Certifikimi I sistemit për Menaxhimin e Cilësisë - ISO 39001 2012- Sistemi I Menaxhimit të Sigurisë së Trafikut Rrugor - PASS 99 2012- Sistemi I Integruar I Menaxhimit - ISO 14001 2015- Sistemi dëshmitë:

1. Një listë të kontratave të realizuara, duke saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve.

5. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licenca ISO valide-kopje të noterizuara.”

Paneli shqyrtues konform Eksperti shqyrtues profesional sqaron se OE ankuese se bashku me dosjen e tenderit ka dorëzuar listat e kontratave të realizuara nga dy anëtarët e konzorciumit, ku në listën e kontratave të dorëzuara nga OE “VictoryCom” si lider i konzorciumit janë paraqitur të dhënat për kontrata të natyrës së ngjashme si vijon:

1 .Sanimi i rrugëve me zhavorr Komuna e Gjakovës në vlerë prej 410,000.00-e filluar 2013 dhe përfunduar 2015,

2 .Furnizimi dhe mirëmbajtja e rrugëve me zhavorr në rrugët lokale dhe Gjurgjevik të madh në vlerë prej 43.700.00-e filluar 2018 dhe përfunduar 2018,

3 .Ndërtimi i shtigjeve për këmbësor Parku i Qytetit në vlerë prej 69,000.00 - e filluar 2015 dhe përfunduar 2016,

4 .Ndërtimi i rrugës Fehmi Agani me vlerë prej 198,119.80- e filluar 2015 dhe përfunduar 2017,

5 .Ndërtimi i rrugës në Fshatin zhub me vlerë prej 149,348.80- e filluar 2015 dhe përfunduar 2017,

6 .Mirëmbajtja e parqeve dhe mbjellja e drunjve dekorative në vlerë prej 88,000.00- e filluar 2015 dhe përfunduar 2017,

7 .Ndërtimi dhe Asfaltimi i rrugës Nimon Ferizi me Vlerë prej 38,600.00 e filluar 2018, dhe përfunduar 2018,

8 .Ndërtimi dhe sanimi i oborrit në vlerë prej 15,000.00e filluar 2017 dhe përfunduar 2018,

9 .Pejsazhi i mbrojtur Shkugeza-dhe asfaltimi i shtigjeve në vlerë prej 98,000.00e filluar 2018 dhe përfunduar 2018.

Pra nëse mblidhen vlerat e kontratave që janë përshkruar më lartë e që kanë përfunduar gjatë tri viteve të fundit (2016,2017 dhe 2018) mund të konstatojmë se vlera e tyre e përbashkët është e barabartë me 699,767.00 €, e cila vlerë është më e madhe se sa 60% i vlerës 750.000,00€ të kërkuar nga AK. Po ashtu OE ankuese ka bashkangjitur edhe referencat për kontratat në fjalë.

Sa i përket certifikatës ISO 9001:2015,Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se OE ankues e ka bashkangjitur ne e-prokurim certifikatën në fjalë por nuk e ka të bashkangjitur dëshminë se e njëjta është e noterizuar siç është kërkuar ne dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë nga AK.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 69 të LPP-së, Paneli shqyrtues konformekspertit shqyrtues profesional konstaton se pretendimi i operatorit ekonomik ankues nuk është i bazuara sepse OE ankues pretendimin në fjalë vetëm e ka cekur sipërfaqësisht pa sqaruar dhe pa dhënë ndonjë fakt rreth shkeljes se këtij neni në deklaratën e ankesës se dorëzuar, po ashtu me nenin 69 të LPP-së rregullohen respektivisht udhëzohen autoritetet kontraktuese se si mund të kërkojnë dhe vendosin në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë kërkesat minimale dhe cilat dëshmi duhet të dorëzohen nga OE lidhur me aftësitë teknike dhe/ose profesionale, gjatë ushtrimit/zhvillimit të një aktiviteti të prokurimit, andaj pretendimi rreth shkeljes se nenit ne fjale nuk qëndron.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 6, 7, 56, 59, dhe 60 të LPP-së, me arsyetimin se: "OE i cilësuar nga AK Komuna e Gjakovës si i suksesshëm nuk i plotëson as kriteret minimale për kontratë siç janë:

Pika 1.

1 .Inxhinieri i cili selite prezantuar nga OE nuk i plotëson kushtet pasi qe ai nuk është INXHINER I KOMUNIKACIONIT POR MAGJISTER I SHKENCAVE TEKNIKE pra po i njëjti është edhe profesor ne fakultetin e Makinerisë. Për të plotësuar kriterin e dosjes se tenderit po i njëjti duhet të ishte me titull: INXHINER I MAKINERIS DREJTIMI KOMUNIKACIONE ose MASTER!MAKINERIS DREJTIMI KOMUNIKACION. Sipas RROUPP-ës kur inxhinier nuk i plotëson kushtet duhet refuzuar.

Pika 2,

2. Inxhinieri i cili është prezantuar nga OE nuk i plotëson kriteret sipas Dosjes se tenderit. Personeli i cili është prezantuar nga OE ka titullin: Inxhinieri i Ndërtimit Civil-Industrial, pra për ta plotësuar Kriterin e dosjes se tenderit duhet të ishte Inxhinieri i Ndertimitarsi-Drejtimi Konstruktiv.

Inxhinier Industrial do të nënkupton inxhinier i Fabrikave industriale pra qe ka lidhje me ndërtimin e fabrikave dhe pjesëve të saj e që është drejtim krejt tjetër me Konstruktivin siç e kërkon dosja e tenderit Pra ky inxhinier nuk i plotëson kushtin si inxhinier të ndërtimtarisë- drejtimin konstruktiv.

Pika 3.

3 .OE ka paraqitur një inxhinier të hidros por Kontrata nuk është e nënshkruar nga të dy palët dhe është në kundërshtim me LPP dhe duhet cilësuar si dokument i pa vlefshëm nga AK.

Pika 4.

4 .OE ka paraqitur një marrëveshje me një OE tjetër për Shkëmb të Fort kurse Licenca është për sortus, pra i cili nuk i plotëson kriteret ne dosjen e tenderit, Sortuesi është (seperacion i cili bene larjen e zhanoreve të lumit)

I mungon Baza e shkëmbit të fort (Gurëthyesit). Dhe duhet eliminuar gjithsesi në bazë te RRUOPP-së.

Pika 5.

Nuk është Plotësuar Aneksi 6 lista e projekteve siç është ne dosjen e tenderit por as Aneksi 7 Lista e makinerisë siç është ne dosjen e tenderit, ka makineri me qera por nuk janë askund ne liste e makinerisë siç do të duhet të plotësuar siç e thotë Lista e Makinerisë.

Pika 6

6, Lista e Çmimeve nuk është plotësuar sipas RROUPP-ës, pasi dhe OE nuk e ka nënshkruar Listën e çmimeve por vetëm ka vulosur dhe sipas RROUPP-ës ky duhet refuzuar menjëherë pa kërkuar sqarime shtesë.

Pika 7.

OE nuk i ka dëshmuar Punëtoret as me kontrata por as listën e ATK-se por vetëm një listë e cila nuk është e vlefshme në qoftë se nuk paraqitet lista e ATK-se ose kontratat e punës”.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional sa i përket pretendimeve lidhur me dokumentacionin e inxhinierit të komunikacionit, inxhinierin e ndërtimtarisë, kontratës me inxhinierin e hidros, listës se çmimeve, listës së punëtorëve, konstatojmë se ky pretendim nuk është i qëndrueshëm për faktin se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar dëshmitë që plotësojnë kërkesat e AK respektivisht ka dorëzuar kopjen e diplomës dhe vendimeve mbi njohjen e titullit për inxhinierin e ndërtimtarisë, kopjen e diplomës se magjistratit te shkencave teknike(sipas informacioneve të marruar e barasvlershme me inxhinierin e komunikacionit), kontratën mbi veprën me inxhinierin e hidros e cila është e nënshkruar nga dy palët, lista e punëtorëve konform kërkesë së AK sepse nuk është kërkuar të dorëzohet listë nga ATK, si dhe ofertën financiare e cila është e vulosur dhe e nënshkruar.

Paneli shqyrtues konstaton se me rastin e rivlerësimit autoriteti kontraktues duhet të vërtetoj pretendimin e ankuesit sa i përket Aneksit 6 listën e projekteve, pra AK të vërtetoj se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës a ka dorëzuar këtë liste konform kërkesës së autoriteti kontraktues. Gjithashtu duhet vërtetohet fakti se OE në fjalë a ka plotësuar kërkesën e AK-së: Licencë-leje e vlefshme të lëshuar nga KPMM-ja ose (bazë betonit ,bazë për gurthyes dhe bazë për asfalt)kopje.Pra autoriteti kontraktues me rastin e Rivlerësimit duhet te vërtetoj se dëshmitë e ofruara nga ana e OE te rekomanduar për dhënie të kontratës për piken-kërkesë e cekur si me lart, a janë në pajtim me kërkesën e specifikuar në dosje e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Goran Milenković



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK-Komuna e Gjakovës

1x1 OE-NSHT "ViktorCom&CompanyMurseli" sh.p. k- Gjakovë.

1x1 Arkivës së OSHP-së

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.